



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DELVINË
DREJTORIA E FINANCES SHERBIMIT SOCIAL E ARSIMIT

Delvinë, më 25.06.2021

Lënda:Njoftim

Lajmërojmë të interesuarit se nga data 21.06.2021 deri më datë 09.07.2021 fillojmë Aplikimet për regjistrimin e fëmijëve në Kopshte dhe Çerdhe publike në varësi të Bashkisë Delvinë .

Aplikanti duhet të dorëzojë pranë kopështeve përkatëse :

Certifikatë Personale të Fëmijës

Vërtetim Banimi

Vërtetim Pune të kujdestarit ligjor (prindërve)

Pas procesit të aplikimit kërkesat do të shqyrtohen sipas dokumentacionit të paraqitur dhe prioritet për regjistrimin do të kenë këto kategori:

Fëmijët me statusin e jetimit

Fëmijë të familjeve ku kujdestari ligjor ka statusin e jetimit.

Fëmijë të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike .

Fëmijët e familjeve mono prindërore ku kujdestari ligjor e ka pagën në /nën nivelin e pagës minimale të miratuar me aktin nënligjor përkatës .

Fëmijët e familjeve ku kujdestari ligjor i fëmijës është i divorcuar ose i ve (sipas çertifikatës së gjendjes familjare).